

PËRMBAJTJA

Shënim i autorit	11
1. Me çdo kusht	17
2. Shpëto mbretin	47
3. I rrënuar dhe i djegur	69
4. Alo! Flas me Ukrspeteksportin?	81
5. Porosia 001	107
6. Dredhim	137
7. Gegh (Sipas originalit anglisht të shkruar në gjuhën shqipe)	161
8. Gjakmarrja (Sipas originalit anglisht të shkruar në gjuhën shqipe) ..	185
9. 22 bunkerët	205
10. Korrupsioni (Sipas originalit anglisht të shkruar në gjuhën shqipe) ...	229
11. Nevojë operative	243
12. Gërdec (Sipas originalit anglisht të shkruar në gjuhën shqipe)	255
13. Akuza	267
Epilog	283
Falënderime	293
Tregues	295

SHËNIM I AUTORIT¹⁾

Në janarin e vitit 2007, dy djem nga Majami Biçi fituan nga Departamenti i Mbrojtjes një kontratë me vlerë prej 300 milion dollarësh për të furnizuar me municion ushtrinë amerikane në Afganistan. David Packouz-i dhe Efraim Diveroli qenë ende paksa mbi të njëzetat, por ishin treguar të zotë, shumë, shumë, shumë të zotë për të fituar onlajn kontrata për furnizimin e trupave ushtarake federale. Drogamanët që tymosnin kanabis, ishin treguar aq të zotë për të bërë marrëveshje me Pentagonin, sa kishin mposhtur një duzinë korporatash konkurrenente dhe ishin bërë fituesit e vetëm të kontratës për furnizimin e ushtrisë afgane me të gjitha llojet e municioneve, nga 100 milionë copë fishekë AK-47, deri te mijëra tonë granata, predha mortaje dhe raketa ajër-ajër. Kontrata e stërmadhe kërkonte aq municion, sa do të mjaftonte, në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës, për të krijuar një ushtri, çka ishte saktësisht ajo që po kërkonin të bënin në atë kohë Shtetet e Bashkuara.

Duke u zotuar të përmbushnin kontratën 300-milionë-dollarëshe, Packouz-i dhe Diveroli futën në lojë edhe dikë tjetër nga grupi i tyre i Majami Biçit, një të quajtur Aleks Podrizki. Trioja kishte gjetur një çast të shkëlqyer për t'u bërë kontrabandistë ndërkombëtarë. Në muajt e parë të vitit 2007 luftërat në Afganistan dhe në Irak po shkonin keq. Disa vjet më parë,

1) *Poshtëshënimet e cilësuar janë të autorit, përndryshe janë të shqipteruesit.*

Shtetet e Bashkuara i kishin pushtuar të dyja këto vende, pa menduar shumë për atë që do të ndodhte më pas, dhe për domosdoshmërinë për të rikrijuar grupe luftarake myslimane. Ndërsa vendet e pushtuara u futën njëkohësisht në kaosin e rebelimeve të pakontrolluara, administrata e Bushit e rriti numrin e trupave ushtarake në Irak në dhjetëra mijëra. Ky veprim i hoqi Pentagonit burimet e nevojshme për trupat në Afganistan, siç vërejtë në mënyrë të përsëritur gjatë fushatës elektorale kandidati jofavorit për postin e presidentit, Barak Obama. Të ndodhura në gjendje të dëshpëruar, Shtetet e Bashkuara vendosën se ishte e nevojshme të sigurohej mbështetje më e madhe strategjike për trupat ushtarake dhe ato policore afgane, çka duhej bërë pa vonesë. Kështu, kontrata për furnizimin me municione ishte pjesë e një nisme madhore në përpjekjen për të mbështetur forcat afgane të sigurisë dhe për t'i kthyer ato në valë goditëse kundër talibanëve.

Marrëveshja për furnizimin me armatim të ushtrive afgane që reflektim i një ndryshimi në politikën kontraktuese të mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara. Në ditët e para të konflikteve në Afganistan dhe në Irak, Pentagoni kishte lidhur pa tender kontrata shumëmiliardëshe me kompani si *Halliburton* dhe *Blackwater*, duke shkaktuar revoltë publike lidhur me mënyrën se si njerëz me lidhje të brendshme me institucionin po nxirrnin fitime nga luftërat. Për t'iu përgjigjur kësaj presidenti Bush i ndryshoi rregullat, duke kërkuar që pjesa më e madhe e kontratave të mbrojtjes të postoheshin në uebsajtin qeveritar, të ishin të hapura ndaj garës dhe të përmbanin kushte që të favorizonin bizneset e vogla, duke u dhënë kështu lojtarëve të veckël si Packouz-i, Diveroli dhe Podrizki një mundësi për të konkurruar me sukses me konglomeratet më të mëdha të kompleksit ushtarako-industrial.

Logjistika e blerjes dhe e transportimit të armëve në sasi të tilla paraqiste sfida serioze. Shto këtu edhe një vështirësi tjetër, atë se afganët dhe irakenët përdornin sisteme armësh të Bllokut Sovjetik. Kjo donte të thoshtë se municioni i kontratës

afgane duhej të sigurohej tërësisht nga vendet ish-komuniste, shumë prej të cilave të përfolura gjerësisht për korrupsion dhe për shitje ilegale të armatimeve. Në këtë përpjekje, me rëndësi jetësore nga pikëpamja strategjike dhe delikate nga pikëpamja politike, Departamenti i Mbrojtjes u mbështet në tre djelmosha gati të panjohur njëzetvjeçarë: një masazhist me licensë, një tjetër që e kishte braktisur shkollën në klasën e nëntë, dhe një të tretë që merrej me shitje droge me pakicë.

Për çudi, të paktën siç del nga versioni zyrtar i ngjarjeve, në vend që të furnizonin Pentagonin me municion të cilësisë së lartë, Packouz-i, Diveroli dhe Podrizki e mbushën atë me një mal municionesh e armatimesh prej atyre të fshehura në vendet e Ballkanit. Në një shkrim që u botua në faqen e parë të *New York Times*-it në marsin e vitit 2008, thuhej se ata patën kokëkrisjen që t'i hidhnin hi syve qeverisë federale, duke i shitur municione të vjetra, të ndryshkura e defektoze, të mashtronin ushtrinë dhe të vinin në rrezik jetën e luftëtarëve të pafajshëm afganë. Kështu, shkrimi i *Times*-it, në njëfarë mënyre, i bëri të famshëm këta djem. Por shkrimi ngriti edhe pyetje serioze: Si ishte e mundur që tre djelmoshave, dukshëm të pakualifikuar e të papërvojë, t'u besohej një kontratë e tillë e stërmadhe e mbrojtjes? Si kishin mundur ata t'u hidhnin hi syve zyrtarëve për një kohë aq të gjatë? A ishte kjo kontratë tipike për mënyrën se si superfuqia e vetme e botës po i bënte luftërat në Afganistan dhe në Irak? Ç'kuptim merrte disfata lidhur me aftësinë e Amerikës për të fituar në luftën kundër terrorizmit?

Si shkrues për *Rolling Stone*,¹⁾ e dija se revista kërkonte vazhdimisht histori të një lloji të caktuar, "histori për të rinj që bënin mashtrime", për ta thënë me fjalët e botuesve. Natyrisht, tre miqtë nga Majami Biçi dukeshin të përshtatshëm për këtë temë. Dukej, madje, se ata jepnin mundësi për një vështrim interesant, madje unik, në botën e fshehtë dhe misterioze të

1) *Rolling Stone*: revistë e përdyjavshme e fokusuar në kulturën popullore. U themelua në San-Francisko në vitin 1967 nga Jann Wenner.

shitjeve ndërkombëtare të armatimeve. Rrugëtimi i pazakontë i Packouz-it, Diverolit dhe Podrizkit përfshinte intriga gjeopolitike, kriminelë shqiptarë, një shitës të nëndheshëm zviceran armatimesh dhe një komplot të fshehtë për të riambalazhuar milionat e stoqeve të fishekëve AK-47 të prodhimit kinez, elemente këto që çonin drejt një padie federale për mashtrim, një hetimi të Kongresit, dhe një skandali që e bëri qeverinë e SHBA-së jo vetëm qesharake, por edhe të paaftë.

E di nga përvoja - një marifet i profesionit ky - se koha më e mirë që një gazetar të trajtojë tema me të akuzuar për krime është pasi ata të jenë dënuar me vendim gjyqi dhe kur forca e tyre legale të ketë prekur fundin. Për këtë arsye, prita derisa David Packouz-i dhe Aleks Podrizki të ishin pranë dënimit për mashtrim federal lidhur me akuzën që ishte ngritur kundër tyre. Kur kontaktova me avokatin e Packouz-it, ai më tha se klienti i tij ishte i gatshëm të më takonte, kështu që shkova në Florida. Kurse Podrizki nuk u tregua ende i gatshëm që të takohej me mua. Përpara gjyqtarit në gjykatën e re plot shkëlqim në Majami, Packouz-i dëgjoi vendimin e pezullimit të përkohshëm të çështjes lidhur me rolin e tij në kontratën mashtruese të Afganistanit. Podrizki, gjithashtu, e shmangu burgun. Miku i tyre, Diveroli, nuk pati aq fat dhe u dënua me katër vjet prapa hekurave për arsye se ishte koka e veprimtarisë.

Në gjykim, prokurori i shtetit i portretizoi Packouz-in, Diverolin dhe Podrizkin si mashtrues të vegjël, si tre të rinj që ishin të gatshëm të bënin gjithçka për të fituar para. Në gazetën *Times*, cilësimi i Packouz-it si terapist masazhist luajti rol të dukshëm, bashkë me rrëfimin e hollësishëm të historisë vetjake të larmishme të Diverolit. Fotografitë e Packouz-it dhe të Diverolit të botuara në gazetë i tregonin ata si kriminelë të regjur.

Por te David Packouz-i pati një veçanti. Ai ishte i zgjuar dhe gojëtar, vrojtues i mprehtë i zhvillimeve, me kujtesë të fortë, me humor dhe plot ironi kur përshkruante kotësinë e

jetës që kishte bërë. Ndryshe nga imazhi hollivudian i një trafikanti armësh, i një banditi të pashpirt që bënte tregti me vdekjen, Packouz-i dukej si një fëmijë i ëmbël që fare mirë dhe me po atë lehtësi mund të kishte nisur një biznes interneti *dot-com* në *Silicon Valley*.

Në vend të shpikjes së një biznesi vrastar, Packouz-i dhe miqtë e tij e kishin paraqitur veten si kontrabandistë armësh: kontrabandistë të çmuar, të shkathët dhe pabesueshmërisht të suksesshëm. Duke fituar një kontratë 300-milionëdollareshe, tre djemtë nga Majami Biçi qenë shndërruar në shitësit më të pazakontë të armëve në histori, derisa mashtrimi i tyre u zbulua dhe Pentagoni i sulmoi.

Artikulli që shkrova në *Rolling Stone*, historia e pabesueshme që tregonte në njëfarë mase për çmendurinë e një dhjetëvjetëshi lufte dhe paligjshmërie, tërhoqi më shumë vëmendje se çdo shkrim tjetër që kisha botuar deri më atëherë. Qe një histori aq e çuditshme, saqë ishte e pamundur të mos qe e vërtetë. Por unë e dija se kishte edhe shumë më tepër që mbetej pa u rrëfyer. Një gjyqtar federal i kishte bllokuar një numër dokumentesh. Duke mos dashur ta lija rastin të më ikte, kalova muaj duke shfletuar procesverbalet e gjyqit, duke studiuar nenet e kontratës me Departamentin e Mbrojtjes dhe duke rrëmuar në nenet e ligjit për Lirinë e Informimit. Kur kërkova të intervistoja zyrtarët e përfshirë në çështje, pati vetëm shurdhëri, por edhe dyshime të mëdha. Më në fund, ndërsa vazhdoja të gërmoja, mora nga burime konfidenciale dokumente që zbulonin të vërtetën. Atëherë, njeriu që e kishte drejtuar këtë veprimtari të shitjes së armatimit, forca e natyrës me emrin Efraim Diveroli, nisi të fliste me mua që nga burgu ku ndodhej. Aleks Podrizki pranoi të më rrëfente përvojat e tij në Shqipëri. Po ashtu, një biznesmen mormon nga Utahu, i quajtur Ralph Merrill, i cili kishte financuar biznesin dhe ishte dënuar gjithashtu për mashtrim, dëshironte të thoshte fjalën e tij për mënyrën se si qenë zhvilluar ngjarjet.

Kështu nisi të merrte formë një tjetër histori, një histori për të cilën nuk qe shkruar kurrë.

Tre drogamanët nga Majami Biçi kishin ndërmarrë një kuturisje të çmendur e të pazakontë në botën e tregtisë ndërkombëtare të armëve. Por historia kishte edhe anën e saj serioze, me pasoja politike dhe ligjore. Zbulova se gjatë luftërave në Irak dhe Afganistan qeveria e Shteteve të Bashkuara ishte shndërruar në organizatën më të madhe kontrabandiste të armëve në planet, me gjasa pa mbikëqyrjen e Kongresit dhe duke iu fshehur ligjit e shtypit. Ndërsa Pentagoni përpiqej me dëshpërim që të organizonte ushtri të reja në Kabul e në Bagdad, duke u paguar kontraktuesve privatë miliarda dollarë për të blerë sasi të stërmëdha armatimesh nga vendet e ish-bllokut komunist, kishte bërë pak përpjekje për të verifikuar partnerët e tij në këtë biznes dhe e kishte bërë syrin të verbër ndaj një mashtrimi të shfrenuar që disa herë kishte rezultuar me pasoja vdekjeprurëse. Qeveria e SHBA-së kishte përdorur një varg ndërmjetësish si Packouz-i, Diveroli dhe Podrizki, për të mos marrë pjesë drejtpërdrejt në tregtinë e pistë të armatimeve në Ballkan, në pagesat nën dorë, në mitëmarrjet dhe lojërat e dyfishta. Ajo i donte ndërmjetësit edhe si kokë turku, në rast se veprimtaritë e paligjshme do të zbuloheshin. Historia e tre djemve nga Majami Biçi ilustronte qartazi dështimet e luftërave në Afganistan e në Irak. Ishte një histori që, deri më sot, qeveria u përpoq ta varroste.

Kjo është një histori të cilën as që ju ka shkuar ndër mend se do ta lexonit ndonjëherë.

Guy Lawson
Nju-Jork,
Qershor 2015